



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Data \_\_\_\_/\_\_\_\_/2014

**Lënda: Vendim**

**V E N D I M**  
Nr 42385, datë 15.09.2014

Bazuar në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar; Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt"; Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar; Statutin e Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a; Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 18, datë 25.06.2014 "Për ndryshime në statutin, kapitalin themeltar dhe gjendjen juridike të Klubit të Futbollit Tirana sh.a",

**VENDOSA:**

1. Të njihet kontributi financiar i Shoqërisë "Halili" sh.p.k, tejkalues i vlerës së sponsorizimit kontraktor për Klubin e Futbollit Tirana, në masën: 202.300.000 (dyqind e dy milion e treqind mijë) Lek.
2. Të zmadhohet kapitali themeltar i Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a në vlerën: 202.300.000 (dyqind e dy milion e treqind mijë) Lek.
3. Zmadhimi i vlerës së kapitalit themeltar të kryhet përmes emetimit të aksioneve të reja, në masën 202.300 (dyqind e dy mijë e treqind) aksione me vlerën nominale 1.000 (një mijë) Lek.
4. Të konvertohet kontributi financiar i Shoqërisë "Halili" sh.p.k në aksione të kapitalit themeltar të Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a, në masën 202.300 (dyqind e dy mijë e treqind) aksione me vlerën nominale 1.000 (një mijë) Lek.
5. Kontributet financiare të cilat konvertohen në aksione, sa i përket zmadhimit të kapitalit themeltar përmes emetimit të aksioneve të reja, do të konsiderohen të nënshkruara dhe të shlyera nga ana e Shoqërisë "Halili" sh.p.k.
6. Kapitali themeltar i reformuar pas emetimit të aksioneve të reja do të jetë 306.300.000 (treqind e gjashtë milion e treqind mijë) Lek, korrespondues i 306.300 (treqind e gjashtë mijë e treqind) aksioneve me vlerë nominale 1.000 Lek.

Aplikanti:  
Lorin Burba

1

7. Ngarkohen ekspertët kontabël të miratuar të Klubit të Futbollit Tirana sh.a për hartimin e Raportit për përcaktimin e shpërndarjes së aksioneve ndërmjet personave juridik pjesëmarrës në kapitalin themeltar.
8. Autorizohet Administratori i Klubit të Futbollit Tirana sh.a të nënshkruajë marrëveshjen për kalimin e të drejtave mbi aksionet e shoqërisë, sa i përket parashikimeve të këtij vendimi.
9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse për vënien në dijeni të këtij vendimi, Shoqërinë "Halili" sh.p.k dhe Klubin e Futbollit Tirana sh.a.
10. Shlyerja e debive të Klubit të Futbollit Tirana sh.a deri në datën e këtij akti do të kryhet në mënyrë të përbashkët nga aksionarët e shoqërisë, në varësi të kontributit në kapitalin themeltar.
11. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Klubi i Futbollit Tirana sh.a për hartimin e marrëveshjes për likuidimin e debive të shoqërisë ndërmjet aksionarëve.
12. Ngarkohen aksionarët e Klubit të Futbollit Tirana sh.a të shlyejnë detyrimet për paga ndaj subjekteve të cilët rezultojnë të punësuar nga shoqëria, brenda datës 31.12.2014.
13. Ngarkohet Klubi i Futbollit Tirana sh.a, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Planifikimit Strategjik për vënien në zbatim dhe regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
15. U shpall sot, më datë 15.09.2014.

**KRYETARI**

Lulzim BASHA

Aplikanti:  
Lorin Burba

2